



- СЕКТОР ЗА СОЦИЈАЛНА ЗАШТИТА -

Numri i arkivit: 10-  
Data:

15-01-2026

Drejtuar: Kryetarëve të Komunave

Lënda: Njoftim – Thirrja e fundit për dorëzimin e aplikimeve për vitin 2026

Të nderuar,

Lidhur me Thirrjen Publike të publikuar në ueb-faqen e Ministrisë së Politikës Sociale, Demografisë dhe të Rinjve, në të cilën mund të aplikojnë të gjitha komunitet e interesuara që kanë nevojë për ndërtim, zgjerim, rikonstruim dhe adaptim të objekteve për krijimin e shërbimeve dhe rritjen e kapaciteteve të ofruesve ekzistues, dhe atë, për shërbime të këshillimit, shërbime në shtëpi, shërbime në komunitet dhe shërbime për mbrojtje jashtëfamiljare për përfituesit e mbrojtjes sociale përmes parashtrimit të Aplikimeve dhe të Projekteve, Ju njoftojmë se Thirrja e fundit për dorëzimin e Aplikimeve dhe të Projekteve është deri më 18.01.2026.

Projektet duhet të jenë në përputhje me Ligjin e Mbrojtjes Sociale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut", nr. 104/19, 146/19, 275/19, 302/20, 311/20, 163/21, 294/21, 99/21, 236/22, 65/23 dhe 192/25), dhe në përputhje me aktet nënligjore që rrjedhin nga ky Ligj.

Me qëllim tejkalimin e problemeve që rrjedhin nga projektet që nuk janë zhvilluar plotësisht sipas standardeve dhe normave për kryerjen e aktivitetit, Ju njoftojmë se është e nevojshme:

1. Komunitet përpara se të angazhojnë kompani për përpilim të projektit bazë, duhet t'i dorëzojnë shkresë MPSDR-së, me njoftimin për qëllimin e përpilimit të projektit, me dokumentacionin e bashkëngjitur për vendndodhjen, i cili do të konfirmonte statusin e pronës (parcels duhet të jetë në pronësi ose të jepet për përdorim të përhershëm nga komuna që aplikon) dhe qëllimin e duhur urban të tokës - B2 (mbrojtja shëndetësore dhe sociale).
2. Pas marrjes së konfirmimit të përshtatshmërisë së vendndodhjes nga personat profesionalë të Ministrisë, komunitet mund të angazhojnë kompani për përpilimin e



## - СЕКТОР ЗА СОЦИЈАЛНА ЗАШТИТА -

- projektit, e cila duhet të jetë e hapur për bashkëpunim dhe sugjerime me personat profesionalë të MPSDR-së.
3. Përpara fillimit të procedurës së përpilimit të zgjidhjes konceptuale, duhet të respektohen dispozitat e akteve nënligjore.
  4. Në fazën fillestare të përpilimit të projektit, komuna duhet të kërkojë takim me përfaqësues të MPSDR-së për prezantim të projektit konceptual dhe për miratimin që ky i fundit është në përputhje me aktet nënligjore që u referohen shërbimeve sociale.
  5. Nëse ka nevojë për konsultime gjatë përpilimit të projektit bazë, komuna mund të kërkojë takim, dhe krahas kësaj, para dorëzimit dhe certifikimit arkivor të projektit bazë, i njëjti duhet të miratohet nga personat profesionalë të MPSDR-së se i plotëson të gjitha standardet dhe normat e përcaktuara.

Të gjitha projektet, pavarësisht burimit të financimit, duhet të jenë në përputhje me Ligjin e Mbrojtjes Sociale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut", nr. 104/19, 146/19, 275/19, 302/20, 311/20, 163/21, 294/21, 99/21, 236/22, 65/23 dhe 192/25), dhe në përputhje me aktet nënligjore që rrjedhin nga Ligji i Mbrojtjes Sociale.

Projektet, së bashku me Aplikacionin, duhet të dërgohen me postë në adresën: Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe të Rinjve, rr. "Dame Gruev nr. 14", Shkup, me shënimin: "Thirrje Publike për financimin e projekteve për ndërtimin, zgjerimin, rikonstruimin dhe adaptimin e objekteve për krijimin e shërbimeve dhe rritjen e kapaciteteve të ofruesve ekzistues, përkatësisht për shërbime të këshillimit, shërbime në shtëpi, shërbime në komunitet dhe shërbime të mbrojtjes jashtëfamiljare për përfituesit e mbrojtjes sociale", jo më vonë se data 18.01.2026.

Me respekt,

Ministri  
Fatmir Limani



Изработил/Пërpiloi: Магдалена Панчевска  
 Контролирал/Контролои: Mr. Слободанка Лазова-Здравковска  
 Превод/Пërkthimi: Kefsere Loka  
 Одобрил/Miratoi: Drita Asllani  
 Одобрил/Miratoi: Љубица Панчева  
 Согласен/Пајтоhet: Fatmir Sabri, Државен секретар/ Sekretar Shtetëror